REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8686/1 **Prot.** **Roskovec, më** 29.10.2026

Procesverbal Nr.10

-I mbajtur sot,datë ***29.10.2026,ora 13^{00}****,në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë,mbledhje e radhës, me rend dite :*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shtator 2026.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Roskovec.
5. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2026.
6. Për miratimin e ndihmës financiare për të dëmtuarin Z.Nexhip Sopiku, si rezultat i fatkeqësisë shkaktuar nga zjarri, në qytetin e Roskovecit, Bashkia Roskovec për vitin 2026.
7. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13^{12}

Këshilltarët prezent: A.Plaka, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, J.Begaj, A.Pelo.

Këshilltarët që mungojnë: E.Çepele, Zh.Metushi, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, P.Toro, A.Hoxha, V.Çepele, S.Bibo Qamili, F.Feleqi.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Sp/ Emergjencave Civile R.Çepele, P/Shërbimit Social E.Kola.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 11 këshilltarë. Kryetari – përshëndetje të nderuar këshilltar, faleminderit që jeni bërë pjesë e kësaj mbledhje. Duke qënë se kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes së muajit Tetor të Këshilit të Bashkisë Roskovec është i pranishëm, pra kemi të pranishëm në sallë 11 nga 21 këshilltar, unë e deklarojë mbledhjen e Këshillit të Bshkisë të hapur. Ashtu siç keni marr dijeni me njoftimin e datës 23.10.2026, sa i takon rendit të ditës për ditëmbledhjen e sotme, nuk kemi asnjë

Bashkia Roskovec-Qendër Roskovec,ëeb:ëëë.bashkiaroskovec.gov.al,info@bashkiaroskovec.gov.al

ndryshim. Në qoftë se dikush nuk e kërkon fjalën për proçedurë, atëhërë ju ftoj të votojmë rendin e ditës pa ndryshim me rendin e ditës me të cilin jeni njohur paraprakisht.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro. Kryetari- me 11 vota pro miratohet rendi i ditës, faleminderit për votimin.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shtator 2026.

Kryetari- vazhdojmë me një informacion të shkurtër mbi vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shtator 2026, Arlinda të lutem sa më shkurt. Sekretarja e Këshillit- të nderuar këshilltar, siç keni dhe informacionin të gjithë bashkëngjitur, në mbledhjen e fundit janë miratuar gjithsej në total 6 vendime, 2 prej të cilave ishin vendime me karakter normativ, dhe i kemi dërguar në Prefekturë për verifikim ligjor. Të dy vendimet janë miratuar nga Prefektura.Vendimet janë shpërndarë në zyrat që u takojnë për tu zbatur, faleminderit. Kryetari- faleminderit Arlinda.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- pasi jeni njohur me procesverbalin, i cili ju ka ardhur bashkë me materjalet e tjera të shpërndara tek ju për këtë mbledhje, ju ftoj të votoni.. Leksi- ai procesverbal aq i detajuar ka qënë me shkrim dore, çka hequr ajo e shkreta..Kryetari- ju ftoj që të votoni procesverblin e mbledhjes së kaluar. Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro. Kryetari- me 11 vota pro miratohet ky projekt-vendim, faleminderit.

4.Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Roskovec.

Kryetari- kemi konstatuar që njëri nga antarët e Këshillit të Bashkisë Roskovec ka ndryshuar vendbanimin. Në lidhje me këtë precedent kemi kërkuar mbledhjen e Komisinit të Mandateve, një përfaqësues e të cilit unë e ftoj që të na bëj me dije relacionin e mbajtur, procesverbalin, më fal raportin në lidhje me këtë konstatim. Ermira Buzi Kryetare e Komisionit të Mandateve lexon raportin e mbajtur nga Komisioni. Ermira- Komisioni i Mandateve i Këshillit të Bashkisë Roskovec pasi shqyrtoi çertifikatën personale dhe të njoftimit verbal nga ana e antares, konstatuan se antarja e Këshillit të Bashkisë Roskovec znj.Aleksandra Behar Lamaj, e subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", ka ndryshuar vendbanimin jashtë territorit të Bashkisë Roskovec dhe konkretisht vendbanimi i saj i ri është në Bashkinë Tiranë, dhe në bazë të dispozitave të ligjit Nr.139/2025 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49 pika 2, 4/a dhe 5, të rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak Roskovec neni 21 pika 1 gërma a, konstatoi se përmbushen kushtet ligjore për mbarimin para kohe të mandatit të antarit të sipërpërmendur. I propozohet Këshillit mbarimi i mandatit para kohe të këshilltarit të listuar si më poshtë: Aleksandra Behar Lamaj, Partia Socialiste. Komisioni i Mandateve: Kryetar - Ermira Buzi, Zëvendëskryetar – Antueno Pelo dhe Sekretar- Habibe Hajdini. Ky ishte raporti i Komisionit të Mandateve. Kryetari- ne kemi përgatitur gjithashtu projekt-vendimin "Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Roskovec". Kush është pro raportit të paraqitur këtu bashkë me projekt-

vendimin përkatës? Kryetari i hedh në votim si më sipër dhe miratohen unanimisht me 11 vota pro. Kryetari- me 11 vota pro miratohet ky projekt-vendim. Për proçedurë ju sqaroj se ky vendim i marr nga Këshilli për mbarimin para kohe të mandatit të këshilltarit të Bashkisë Roskovec, i përcillet zyrtarisht Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, i cili vazhdon proçedurën për të përzgjedhur kandidatin e ri, i cili do ti shtohet Këshillit të Bashkisë Roskovec, nga listat paraprake të depozituara nga subjektet zgjedhore në momentin e zgjedhjeve të kaluara.

5. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2026.

Kryetari- me materjalet jeni njohur, specialisten e kemi këtu, i qëndrojmë..Leksi- po, traditës që kemi..Këshilltarët shprehen po.. Kryetari- atëherë ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin "Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2026". Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro. Kryetari- me 11 vota pro miratohet dhe ky projekt-vendim, faleminderit për votimin.

6.Për miratimin e ndihmës financiare për të dëmtuarin Z.Nexhip Sopiku, si rezultat i fatkeqësisë shkaktuar nga zjarri, në qytetin e Roskovecit, Bashkia Roskovec për vitin 2026.

Kryetari- për të relatuar këtë projekt-vendim, z.Ramadan Çepele do të na relatojë, shkurtimisht. Sp/Emergjencave Civile Ramadan- përshëndetje të gjithëve të nderuar anëtar të Këshillit Bashkiak, jam këtu për të paraqitur projekt-vendimin "Për miratimin e ndihmës financiare për të dëmtuarin Z.Nexhip Sopiku, si rezultat i fatkeqësisë shkaktuar nga zjarri, në qytetin e Roskovecit, Bashkia Roskovec për vitin 2026". Ju paraqes për diskutim dhe miratim, miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e Z.Nexhip Sopiku, ndodhur në qytetin e Roskovecit, Bashkia Roskovec, me vlerë 443 mijë e 180 lekë. Miratimin e masës financiare, e cila akordon në rastin e humbjes së jetës së antarëve të familjes, si pasojë e fatkeqësisë 500 mijë lekë. Shpërblimi finaciar do të përballohet nga fondi i Emergjencave Civile të buxhetit të Bashkisë Roskovec, nga të ardhurat e Bashkisë Roskovec. Bazuar në ligjin Nr.45/2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës financiare shtetërore, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga..Leksi- o Kryetar me leje, ne materjalin e kemi para..Jorgo-ta kalojmë në votim..Leksi- kaloje në votim..Kryetari- atëherë të nderuar këshilltar, duke qënë se projekt-vendimi është i ndërtuar mbi një ngjarje shumë të dhimbshme për një nga qytetarët tanë, një qytetare e komunitetit tonë ka humbur jetën, përpara sesa të kalojmë në votimin e këtij projekt-vendimi, ju propozojë të mbajmë 1 minutë heshtje. Këshilltarët ngrihen në këmbë dhe mbajnë 1 minutë heshtje. Kryetari- e paharruar qoftë..Këshilltarët- qoftë e paharruar..Kryetari- ka dikush ndonjë pyetje apo diçka për të diskutuar në lidhje me projekt-vendimin? Leksi- i tha të gjitha 1 minutë heshtje, kaloje në votim..Kryetari- atëherë ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin "Për miratimin e ndihmës financiare për të dëmtuarin Z.Nexhip Sopiku, si rezultat i fatkeqësisë shkaktuar nga zjarri, në qytetin e Roskovecit, Bashkia Roskovec për vitin 2026". Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro. Kryetari- me 11 vota pro miratohet dhe ky projekt-vendim, faleminderit për votimin.

7.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari- ka dikush nga këshilltarët? Qytetar ne nuk kemi të pranishëm, as të regjistruar për të diskutuar, nga këshilltarët e kërkon dikush fjalën? Nuk ka diskutime nga këshilltarët. Kryetari-atëherë askush nuk e kërkon fjalën, faleminderit për praninë në këtë mbledhje, e deklarojë të mbyllur mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Afrim Plaka